

V E N D I M
Nr.331, datë 29.5.2003

**PËR KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJNË NËPUNËSIT E SHËRBIMIT TË JASHTËM
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË PËRZGJEDHJEN PËR MARRJEN E GRADËS
“AMBASADOR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16 e 29 të ligjit nr.8370, datë 9.7.1998 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Nëpunësit e shërbimit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë, në përzgjedhjen për marrjen e gradës “Ambasador”, duhet të plotësojnë këto kushte:

- a) të kenë vjetërsi pune mbi 15 vjet në shërbimin e jashtëm;
 - b) të kenë stazh shërbimi në post drejtues në shërbimin e jashtëm, jo më pak se 10 vjet;
 - c) të plotësojnë kushtet e parashikuara në paragrafin e parë të pikës 1, të nenit 31 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
 - ç) të kenë punuar në shërbimin e jashtëm për 5 vitet e fundit në vazhdimësi;
 - d) të jenë dekretuar “Ambasador” jo më pak se 3 herë;
 - dh) të marrin vlerësim maksimal në aftësi profesionale dhe në rezultatet e punës.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano